

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i përgjithshëm penal sipas gjyqtarit Skender Shefkiu, me asistenten Sahadete Korrani, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M.. nga fsh.S. K.V. me qka ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së sipas aktakuzës të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr,xxx të dates xxxxx e perfaqsuar nga prokurori Esat Ademi pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik me 30.06.2017, shpalli dhe komunikoi këte:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. M. nga babai Xh. dhe nenes M....., e vajzerise, L... data e lindjes xxxxxx, ne fsh.xxx K.Viti ku edhe jeton ka te kryer shkollen e mesme, i punesuar, i martuar ,prindë i xxxx femijeve me gjendje te mesme ekonomike, shqiptarë, Shtetas i Republikës se Kosoves.

**Ë S H T Ë F A J T O R
S E P S E**

Me date xxx xxxx, rreth ores xxxx, ne terrenin e fshatit Sxxx K.Viti ne vendin e quajtur "xxxx i xxx" te administruar nga autoriteti pyjor komunal, zyra ne Viti i pandehuri Bxxx Mxxx, me qellim vjedhje ka prere ne menyre te palejueshme me sharre motorike,xxx copa trugje te llojit tea hut dhe skozes, me diameter xxx cm, ne lartesi prej xxxcm si dhe vellim te pergjithshem prej 4,34 m³ keshtu qe i pandehuri me veprimet e tij i ka shkaktuar te demtuares AKP-es dega ne Viti , dem material ne vlere prej xxxx00€

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.

-Andaj Gjykata ne baze te neneve 7,17, 23, 41, 45, 46,e 73, 74, 75 të KPRK-es, dhe nenit 365 te KPPRK-së.

E G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 200.00 €, (dyqindë euro).

Denimin me gjobë do ta paguaj ne afat prej **15 ditësh**, pasi Aktgjykimi të merr formen e prerë. në të kunderten denimi i shqiptuar do ti zavendësohet me denim burgu në kohë zgjatje prej **10 ditësh**, duke llogaritur nga 20 € per nje ditë burgu konform nenit 46.parag. 3 të KPRK-ës.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguajë Gjykatës shumën prej **20.00 €uro (njëzet euro)** dhe paushallin Gjyqësor në shumë prej **10.00 euro (dhjetë euro)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTHSH nga Gjilani me aktakuzen PP.II.nr, xxxxxx të xxxx e ka akuzuar B...M...nga fsh.S... K.Viti, për shkak të veprës penale, **vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 te KPRK-së.**

Fjala Hyrëse e PTHSH -Esat Ademi prokuoria themelore ka ngritur aktakuzen kundër të akuzuarit B...i M... ku kjo aktakuz ishte e mbështetur në provat materiale që janë fletëparqitjet për dëmtimin e pyllit të APK -zyra në Viti me nr.xxxx datës si dhe me ndëgjimin e dëshmitave M... K... andaj PTHSH konsideron se pas ndëgjimit dhe administrimit të ketyre provave materiale do të provohet fajësia e të akuzuarit që kjo aktakuzë ia ve në barrë.

PTHSH- Esat Ademi në fjalën përfundimtare deklaroi: pas senaces se shyrtimit gjyqsor , leximin e fletpraqitjes per demin e pyllit dhe ndegjimin e deshmitarit por edhe vet i akuzuari nuk e kishte mohuar faktin se ishte takuar nga rojet e pyllit ne vendin ashtu siq ishte e pershkuar ne dispozitivin e kesaj akatakuze por per ti ikur pergjegjesi penale e kishte mohuar faktin qe ka pasur te ngarkuar kete aktakuz me arsyetim se nuk ka pasur mbi dy metra dru, fakte kto dhe prova vertetohet se i njeiti e kishte kryer ket veper penale andaj edhe ka qendruar pran kesaj aktakuze dhe propozimeve qe e njeita i permbante dhe ka kerkuar nga Gjykata qe te njejtin ta shpall fajtor dhe ta denoj sipas ligjit. Me rastin e caktimit dhe lartesis se denimi i ka propozuar Gjykates qe te merr parasysh te gjitha rrethanat lehtsuese dhe renduese, me qellim qe denim te jet ne proporcion me demin e shkaktuar te demtuares si dhe rrezikshmerin shoqerore.

Dëshmia e dëshmitari M... K.... ishte e vertet se ka qen bashk me S..... me vetur deri tek rruga e livadhit te C... , kishin ndegjuar zhurmen e motor sharres per prerjen e drunjeve pastaj kishin vazhduar rrugen ne drejtim te kesaj zhurme, kishin hasur tek nje person tjetër i cili quhej M.. B... ku edhe ati i kishin ushtruar fletparaqitje pastaj kishin vazhduar rrugen ne drejtim te zhurmes kishin mbrri tek livadhi i gjelbert atehere ishin ndar te dy ne dy ane per te shkuar tek vendi ku u ndegjojke zhurma, ishte e vertet se S... ka mrrri tek vendi i ngjarjes dhe per pak minuta kam mrrri edhe un, S..i kishte biseduar me B... ndersa vete kishte ndegjuar, ai kishte qen me traktor rakovis me ram duke i ngarkuar drut ne ram , drut ishin te perziera ah dhe shkoz , i kishin numeruar drut e prera me diametrin e tyre e kemi ver ndersa llogaritjen e kishte bere tekniku i pylltaris, kan biseduar me te, un me nuk kam hasur mqense nuk eshte tereni im eshte tereni i pylltarit tjetër, drut ishin te prera me sharr motorike.

Mbrojtja e te akuzuarit -B.. M...- deklaroi se ishte e vertet se kam qen at dit ne mal dhe ishin takuar nga rojtaret S... S... dhe M...i K...i un nuk i kam prer xxx cop drunje por ata nje pjes te vogel e kam prer por nje pjes tjetër ishin te prera, kam pasur motor sharren me veti , drut kan qen te holla dhe kan qen te perziera te thata dhe te njoma , besoj qe sasija e drunjeve ka qen 3 metra .

Fjala perfundimtare e te akuzuarit B... M.. i njeiti kishte deklaruar që të lirohet nga kjo aktakuzë e nese gjen ndonje elemet te fajsis ka kerkuar nga Gjykata qe ti shqiptoj nje denim sa me te but.

Gjykata pas vlerësimit te provave dhe dëshmimeve ka ardhur ne bindje te plote, se i akuzuari ka kryer veprën penale me te cilen ngarkohet dhe ate:

Deshmia e deshmitarit M... K... - ngase pas zhurmes qe kishin ndegjuar te motor sharres per prerjen e drunjeve kishin shkuar tek vendi i ngjajres se bashku me S.. qe quhej rruga" e livadhut te C..., dhe kishin biseduar me te Akuzuarin dhe ai kishte qene me traktor "R..." duke i ngarkuar drunjet drunjet ishin Ah dhe Shkoz. Andaj **Gjykata ia fali besimin deshmitarit** ngase si deshmi ishte edhe fletparaqitja qe e kishte shkruar i ndjeri deshmitarit S...n S....

Mbrojtjes se te akuzuarit B. M.. Gjykata nuk ia fali besimin nga se me çdo kusht tentonte t'i ikte përgjegjesisë penale, nuk kishte fakte per ta mbeshtetur tezen e vet se nuk ishte fajtor ngase, edhe vet e kishte pranuar qe kishte qen ne vendin e ngjarjes dhe i kishte takuar dy deshmitaret S. S..dhe M. K., si dhe qe kishte pasur me vete motosharren per prerjen e drunjeve.

Bindja e Gjykatës së denimi i shqiptuar është i ligjshëm, është në proporcion me veprën penale, përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se me denimin e tillë të shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij denimi.

Gjykata vleresoi se ne veprimet e te akuzuarit ekzistojne te gjitha tiparet e vepres penale prandaj Gjykata e shpall fajtor dhe e ndeshkon si ne dispozitiv te ketij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450, të KPPRK-së.

Nga te cekurat me lartë u vendos si ne dispozitiv te ketij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI

P.nr.100/2016

Më dt.30.06.2017

**Asistentja,
Sahadete Korrani**

**Gj y q t a r i,
Skender Shefkiu**

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankes në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.